



Planuar / Dorezuar Primitjen/Prodato Received / Delivery	15.03	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHK	1149/2021		114	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.69/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, dhe Avdyl Bektoshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.69/2021 të datës 09.02.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Xhevat Begolli", pa numër në Pejë, kundër masës disiplinore Vërejte me shkrim të datës 08.01.2021 të shqiptuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike "masës disiplinore-vërejtje me shkrim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.03.2021, mori këtë

### V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.69/2021 e datës 09.02.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vërejtja me Shkrim e datës 08.01.2021 e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës e shqiptuar ndaj ankuesit.

### A r s y e t i m

Ndaj ankuesi i punësuar në pozitën sipas ndryshim dhe plotësim të aktit të emërimit të datës 24.03.2020 në pozitën "Drejtor i Drejtoratit për Hulumtime, Projektme dhe Prodhim Fidanore në Pejë" në kuadër të Agjencisë Pyjore të Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, më datë 08.01.2021, ka shqiptuar masën disiplinore "vërejte me shkrim" me arsyetimin se "...për mos raportin të saktë nga gjendja në teren në fidanishten pyjore në arrabërd Pejë të pasqyruara sipas raportit për fidanët e regjistruara (numëruar) nga komisioni i jashtëzakonshëm për vitin 2019, mos harmonizim të raporteve si dhe mosmarrje e masave ndaj zyrtarëve vartës për mosparaqitje të saktë të

*numrit të fidanëve, mos harmonizim të tabelave raportuese si dhe mos paraqitje me kohë e rasteve për marrjen e masave preventive ndaj OE për mos mbirjen e fidanëve...”*

Ankuesi kundër masës disiplinore Vërejtje me Shkrim të datës 08.01.2021 të shqiptuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, nëpërmjet postës më datë 06.02.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 09.02.2021 dhe është regjistruar më Nr. Port:573/2021, më pretendimet ankimore se masa disiplinore e shqiptuar është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, më datë 15.02.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Agjencia Pyjore e Kosovës. Këshilli më datë 24.02.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia Pyjore e Kosovës.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 09.02.2021 me Nr. prot:573/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtje me Shkrim e datës 08.01.2021; Vendimi i datës 14.05.2020 për emërimin e Komisionit për regjistrimin e fidanëve në Fidanishten Arrabërdës; Raporti i komisionit për regjistrimin e fidaneve në fidanishten Arrabërdës i datës 20.08.2020; Vendimin e datës 18.09.2020 për emërimin e komisionit për regjistrimin e jashtëzakonshëm të fidanëve në fidanishten e Arrabërdës; Raportin e komisioni të jashtëzakonshëm për regjistrimin e fidanëve në fidanishten pyjore të IPK-së në Pjesë i datës 30.11.2020; Raporti Vjetor i DHPPPF-së Janar-Dhjetor 2019 nga Drejtoria për Hulumtime, Projektme në Pyje dhe Prodhim Fidanor; E-maili i datës 18.02.2021; E-maili i datës 02.03.2020; Dëshmi të ilustruara me fotografi lidhur me mbirjen dhe numrin e fidanëve në Fidanishten ne Orrobërd për vitin 2019 i datës 17.04.2020 se bashku me fotografitë; Raporti i komisionit për regjistrimin e fidanëve në fidanishten e Arrabërdës i datës 30.09.2020; Pasqyra e fidanëve të regjistruara nga komisioni i jashtëzakonshëm në fidanishten e IPK-së në Arrabërd për vitin 2019 mosha 2+0; Fotot dhe numri i kasetave të fidanëve 2020; Plotësim, ndryshim i raportit nga të datës 30.11.2020 i datës 22.12.2020; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 24.02.2020; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 15.06.2012; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 26.01.2021 dhe 30.12.2019 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 24.02.2021 nga Agjencia Pyjore e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit I është e pabazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit se masa disiplinore është shqiptuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ka konstatuar që nga Raporti Vjetor i Punës së Drejtorisë për Hulumtim, Projektim në Pyje dhe Prodhim Fidanor për periudhën janar-dhjetor 2019 konstatohet që numri i fidanëve të prodhuara është gjithsejtë 1,401.000, ndërsa ankuesi me datës 17.04.2020 ka përcjell tek Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës shkresë me dëshmitë e ilustruar me fotografi në lidhje me të gjitha aktivitetet rreth mbirjes së farave të fidaneve pyjore ne Orroberd në vitin 2019 duke paraqitur që

nga komisioni janë prodhuar gjithsejtë 777.595 prej 1,400.000 të planifikuara, ndërsa fara të dështuar janë gjithsejtë 637.559.

Ndërsa në bazë të provave të lëndës, konstatohet se komisioni për regjistrimin e fidaneve në fidanishten e Arrabërdës ka dërguar raport më datë 30.09.2020 në bazë të të cilit konstatohet që ka një mospërputhje prej rreth 705.293 fidanëve të prodhuara në vitin 2019, ndërsa më datë 18.09.2020 Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës ka nxjerr Vendim me numër Ref:KE-746/20 për emërimin e komisionit për regjistrimin e jashtëzakonshëm të fidanëve në Fidanishten e Arrabërdës, ndërsa i njëjti komision më datë 30.11.2020 ka paraqitur raportin për gjendjen në fidanishten pyjore të IPK-së në Pejë duke konstatuar që për vitin 2019 të planifikuara për mbjellje fidanë kanë qenë 1,500.000, të mbira janë 887,852, ndërsa i njëjti komision në bazë të raportit plotësues të datës 22.12.2020 ka konstatuar që të planifikuara për mbledhje të fidaneve në vitin 2019 kanë qenë 1,401.000 ndërsa të mbira kanë qenë 887.852 fidane.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës konstaton se Drejtoria për Hulumtim, Projektim në Pyje dhe Prodhim Fidanor është përgjegjëse për këto aktivitete, respektivisht ankuesi si udhëheqës i saj është përgjegjës për raportim të saktë dhe të drejtë, ndërsa është përgjegjës edhe për mbarëvajtjen e aktiviteteve të drejtorisë, ndërsa në bazë të raporteve të lartcekura ka një mos harmonizim dhe mospërputhje mes të dhënave tabelare.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se ankuesi përveç tjerash është përgjegjës edhe për vartësit e tij, rrjedhimisht është përgjegjës që nëse nuk ka raporte të sakta nga vartësit e tij në pajtim me procedurat ligjore të ndërmarr masa, përndryshe çdo mos veprim është shkelje e detyrave të punës, po ashtu Drejtoria për Hulumtim, Projektim në Pyje dhe Prodhim Fidanor si drejtori përgjegjëse për prodhim fidanor ka qenë përgjegjëse të raportoje saktë dhe në kohë për mos mbirjen e fidanëve respektivisht dështimin e një numri të madh të fidanëve, në këtë rast Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se veprimet e ankuesit për mos harmonizim/mospërputhje të tabelave raportuese si dhe mos paraqitje me kohë për mos mbirjen e fidanëve, janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht veprimet e tij janë në kundërshtim me nenin 46 paragrafin 4 nën paragrafët 4.3 dhe 4.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ankuesi me veprimet e tij për mos ndërmarrjen e masave ka shkaktuar pasoja për institucionin.

Në bazë të këtyre, është konstatuar që ankuesi ka bërë shkelje të lehtë disiplinore, me ç'rast Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës si udhëheqës i drejtpërdrejtë i ankuesit, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësimit disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit*, mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit "vërejtje me shkrim", është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, sepse është shqiptuar në raport të drejtë me shkeljen e kryer, rrjedhimisht Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të*

fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil", nenin 13 paragrafin 4 nën paragrafët 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe Alerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.69/2021**

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Eshref SHABANI**  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

